# HAPAT E ARDHËSHME:

- *Kontaktoni një nga partnerët tanë për informacion në lidhje me aplikimet dhe intervistat, në varësi të rajonit dhe vendit*
- *Merrni pjesë në një sesion intervistimi me një ide për një biznes ose investime të mëtejshme që mund të jenë të suksesshme si në një dyqan në vendin tuaj, ashtu edhe në një dyqan në interne*
- *Nëse përzgjidhet, jini të përgatitur për t'u takuar me anëtarët e zyrave tona dhe të merrni pjesë në sesione trajnimi që do t'ju ndihmojnë të zhvilloni idetë tuaja të biznesit dhe investimeve*

# KUSH JEMI NE:


***Qendra për menaxhim me ndryshimet (QMN)***
***Rr. ''Rajko Zhinzifov'' 44/1, 1000 Shkup***
***Web-faqja***: www.cup.org,.mk
E-mail ***adresa***: info@cup.org.mk
***Tel dhe fax***: +389 2 6092-216

***Qendra për studime komparative dhe ndërkombëtare(QSKN)***
***Rr***.Elbasanit pallati filipeu ***nr***.4e, ***Tiranë***
***Web-faqe***: http://www.qskn.al/
E-mail ***adresa***: qskninfo@gmail.com
***Tel***.: +355 67 28 72 736

***Instituti për të drejtat e njeriut(IDNJ)***
***Adresa***: ***rr***. „***Rajko Zhinzifov***" 49A, 1000 ***Shkup***
***Web faqja***: www.ihr.org.mk
E-mail ***adresa***: ihr@ihr.org.mk
***Tel***.: (+389) 2 3243 331

***Fondacioni Egalite***
***Rr. 101/1, 1221 Kamjan, Tetovë***
***Web-faqja: www.foundationegalite.org***
***E-mail adresa: infofondacija@gmail.com***
***Tel***: 078 ***275 919***


BE për TY!

# PROJEKTI I ZHVILLIMIT TË NDËRMARRJEVE TË VOGLA PËR GRATË NË ZONËN NDËRKUFITARE



# MISIONI:

*Misioni ynë është të ofrojmë ndihmë dhe trajnim për gratë që duan të bëhen sipërmarrëse. Ne i ndihmojmë gratë të ndjekin pasionin e tyre në krijimin e biznesit të tyre në një mënyrë që do t'i fuqizojë dhe t'i përgatisë për të gjitha sfidat e sipërmarrjes. Ne ofrojmë këshilla dhe konsultime, ngrisim pyetje relevante, flasim për rreziqet dhe si t'i kontrollojmë ato, planifikojmë së bashku dhe parashikojmë kosto dhe rrisim efektivitetin në të bërit biznes.*

*Ne gjithashtu përpiqemi të sigurojmë mbështetje për sipërmarrësitë e sapokrijuar të grave, t'i fuqizojmë ato me aftësi dhe kapacitete të reja. Ne flasim për produkte dhe shërbime të reja të mundshme dhe gjejmë mënyra të reja për të rritur kapacitetin e tyre të shitjeve, për të investuar më tej dhe për të përtërirë dhe për të gjetur tregje të reja.*

# LOKACIONET:

*Ky program është për gratë që banojnë në rajonin ndërkufitar ndërmjet Elbasanit dhe Pollogut. Biznesi duhet të operojë edhe në rajonin më të gjerë ndërkufitar, në mënyrë që të ndihmojë të përfitojnë ekonomia lokale mes dy vendeve.*




# Ç'FARË DUHET TË BËNI:

*Nëse ky program është me interes për ju, ne ju inkurajojmë që të n'a kontaktoni me idenë tuaj të biznesit rreth fillimit të mundshëm dhe / ose planit të ri të investimeve në kompaninë tuaj ekzistuese. Mendoni për atë që njerëzit kanë nevojë dhe duan, dhe çfarë mund t'i ofroni ekonomisë. Ne dëshirojmë që punëtorët e gatshëm dhe të përkushtuar të jenë pjesë e këtij projekti; nëse kjo ju përshkruan, atëherë n'a kontaktoni ose merrni pjesë në një nga thirrjet tona të hapura.*

# AJO QË NE OFROJMË:

- *Zhvillimi dhe organizimi i punëtorive grupore ku mund të zhvillohet udhëzimi, rrjetëzimi dhe të mësuarit*
- *Sigurimi i mbështetjes ligjore për biznesin dhe pronarët e tyre, të cilët mund të mos jenë të njohtuar me ligjet lidhur me themelimin dhe drejtimin e një biznesi*
- *Sigurimi i shërbimeve të këshillimit për biznesin për shumë fusha të ndryshme të menaxhimit dhe administrimit të biznesit*
- *Organizimi i ngjarjeve me autoritetet kombëtare, rajonale dhe lokale, si dhe bizneset, bankat dhe aktorët e tjerë*
- *Organizimi i shërbimeve të marketingut të drejtpërdrejtë dhe aktiviteteve të tregtisë elektronike, si dhe krijimi i një dyqani në internet për shitje të produkteve.*

*Ky publikim është përgaditur me ndihmën e Unionit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Qendra për Administrim me Ndryshime dhe në asnjë mënyrë nuk reflekton opinionin e Unionit Evropian.*

Center for Change Management QSKN / CCIS Institute for Human Rights Foundation Egalite Women & Youth Entrepreneurship